



## AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

### PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR MARRJEN E SHKALLËVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE TË LËNDËS TIK 2021

#### 1. HYRJE

Aftësia e mësuesve për ta bërë arsimimin e nxënësve, “preokupimin” kryesor të ditës, kërkon përkushtim, përgjegjshmëri dhe standarde të larta në punë dhe sjellje. Mësuesit veprojnë me ndershmëri dhe integritet, kanë njohuri të forta përmbajtësore, përdorin dijet dhe aftësitë e tyre, por në të njëjtën kohë përditësojnë njohuritë nëpërmjet vetëvlerësimeve të vazhdueshme, krijojnë marrëdhënie pozitive profesionale dhe punojnë me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve të tyre.

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës së TIK-ut është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t’u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së TIK-ut në përgatitjen për testimin kombëtar për marrjen e kategorive të kualifikimit si dhe të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MASR-ja ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- dokumente zyrtare<sup>1</sup>, të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë e mësimdhënie – nxënies;
- programe përkatëse lëndore;

<sup>1</sup> Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASR-së që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie në përgjithësi, si dhe të lëndës “TIK” në veçanti;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore të lëndës sipas programeve lëndore përkatëse.

## 2. QËLLIMI I PROGRAMIT

Qëllimi i hartimit të programit të zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi është:

- *Së pari*, të ofrohet si një program orientues për t’u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së TIK-ut në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DRAP-eve, ZVAP-ve, për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DRAP-et, ZVAP-të, përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete.
- *Së dyti*, të ofrohet si një program i detyruar, për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar.

### ***Programi synon që mësuesi:***

- njeh dhe zbaton legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore;
- zotëron kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- demonstroi aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- tregon përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- njeh konceptin e gjithëpërfshirjes dhe demonstroi përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- demonstroi zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;

- zotëron zbatimin e rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie –nxënies;
- përdor aftësitë e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si një nga rrisitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca.

### 3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Për secilën fushë, përcaktohen:

- kompetencat profesionale, si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

<b>FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE</b>	
<b>Kompetenca</b> “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor”	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><i>Mësuesi i TIK-ut:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe dispozitat normative të këtij sistemi;</li> <li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;</li> <li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës;</li> <li>• demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MASR-së në funksion të përmirësimit të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</li> <li>• Udhëzuesi “Për fillimin e vitit shkollor 2020-2021”, ASCAP (Gusht 2020).</li> <li>• Shtojca 1 “Për disa plotësime në Udhëzuesin e fillimit të vitit shkollor 2020 – 2021”.</li> <li>• Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020.</li> </ul>

<p>procesit të mësimdhënie-nxënies;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zbaton etikën profesionale të mësuesit;</li> <li>• respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit;</li> <li>• respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit;</li> <li>• zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 14, datë 28.07.2016 “Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë”.</li> <li>• Urdhri Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”.</li> <li>• Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> </ul>
--	--

<b>FUSHA: PROGRAME LËNDORE</b>	
<b>Kompetenca</b> <b>Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të TIK-ut në shkollë</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><i>Mësuesi i TIK -ut:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të zbatojë programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij;</li> <li>• të përdorë programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim;</li> <li>• të jetë krijues në zbatimin e programit;</li> <li>• të përdorë me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza kurrikulare, 2014.</li> <li>• Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014.</li> <li>• Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016.</li> <li>• Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX dhe klasa X -XII.</li> </ul>

programit;

- të shoqërojë objektivat e programit me tema mësimore konkrete të marra nga tekstet ose burimet e internetit;
- gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre;
- të kategorizojë objektivat e programit sipas shkallëve të njohjes;
- të hartojë objektiva specifike që u përgjigjen niveleve të ndryshme të nxënësve;
- të tregojë koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të TIK-ut);
- të shpjegojë lidhjen program lëndor-standarde lëndore;
- të shpjegojë përdorimin e objektivave të programit për vlerësimin e nxënësve;
- të shpjegojë parimet e hartimit të një testi;
- të shpjegojë lidhjen program-tekst nxënësi;
- të për zgjedhë mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programit;
- të planifikojë një orë mësimore me të gjitha hapat e njëpasnjëshëm;
- të sigurojë informacion që demonstroi lidhjen e TIK-ut me shkencat e tjera dhe me jetën reale.

**FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT  
TË TIK-UT NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE**

<p align="center"><b>Kompetenca I</b></p> <p align="center"><b>Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e TIK-ut</b></p>	<p align="center"><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><i>Mësuesi i TIK -ut:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij;</li> <li>• përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve;</li> <li>• demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit;</li> <li>• identifikoi nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar);</li> <li>• planifikoi punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta;</li> <li>• demonstroi qëndrim pozitiv ndaj shkencës dhe lëndës së TIK -ut;</li> <li>• edukoi të nxënësit dashuri dhe kërshërinë ndaj lëndës së TIK -ut;</li> <li>• motivoi nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre;</li> <li>• krijoi klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit;</li> <li>• punoi me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit me nxënësit e tij.</li> <li>• Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015.</li> <li>• Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017.</li> <li>• Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz, 2016.</li> <li>• Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, IZHA (sot ASCAP) 2018.</li> <li>• Udhëzues për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë dhe për mbylljen e vitit shkollor 2019-2020, ASCAP, (Maj 2020).</li> </ul>
<p align="center"><b>Kompetenca II</b></p> <p align="center"><b>Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e TIK-ut</b></p>	<p align="center"><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><i>Mësuesi i TIK -ut:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• organizon orën e mësimit bazuar në rezultate për</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017.</li> </ul>

<p>çdo tematikë mësimore;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• vendos rezultatet e pritshme të orës së mësimi duke u bazuar në taksonominë e Bloom-it;</li> <li>• vlerëson nxënësin bazuar në rezultatet e pritshme;</li> <li>• përzgjedh metodat, strategjitë dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objektivi të caktuar;</li> <li>• përdor metodën e punës në grupe për detyra ose projekte;</li> <li>• përdor metoda e strategji që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve;</li> <li>• përdor metoda e strategji që nxitin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve;</li> <li>• përdor metoda e strategji që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen;</li> <li>• përdor teknologjinë duke realizuar sa më shumë orë mësimore në laboratorin e TIK-ut, në klasë me videoprojektor, me simulime, video mësimore etj.;</li> <li>• përdor strategji të ndryshme të zgjidhjes problemore;</li> <li>• zbaton metoda e strategji që edukojnë një qëndrim pozitiv ndaj lëndës së TIK-ut.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz, 2016.</li> <li>• Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA (sot ASCAP) 2016.</li> <li>• Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, IZHA (sot ASCAP) 2018.</li> <li>• Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>), Shtator 2019.</li> <li>• Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së TIK-ut në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018.</li> <li>• Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së TIK-ut në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018.</li> <li>• Udhëzues për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimi në distancë dhe për mbylljen e vitit shkollor 2019-2020, ASCAP, (Maj 2020).</li> <li>• Udhëzuesi “Për fillimin e vitit shkollor 2020-2021”, ASCAP (Gusht 2020).</li> </ul>
<p><b>Kompetenca III</b></p> <p><b>Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies</b></p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><i>Mësuesi i TIK -ut:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• prezanton materiale matematikore duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Excel, Math Type në Word;</li> <li>• nxit nxënësit të bëjnë prezantime duke përdorur</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tekste nxënësi apo materiale në ndihmë të mësuesit të lëndës së informatikës.</li> <li>• Për gjimnazin merren për bazë programi i TIK-ut për klasën X dhe XI, 2016.</li> <li>• Literaturë që ka në fokus përdorimin e</li> </ul>

<p>programe kompjuterike të njohura për ta;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• gjen dhe përdor materiale nga Website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien;</li> <li>• përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së TIK-ut apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga website.</li> </ul>	<p>programeve kompjuterike.</p>
---	---------------------------------

### FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

<b>Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><i>Mësuesi i TIK-ut:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njih rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;</li> <li>• sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar.</li> <li>• Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar.</li> </ul>

### FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

<b>Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><i>Mësuesi i TIK-ut:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• njih rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe;</li> <li>• demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Literaturë dhe udhëzues metodikë për përdorimin e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.</li> </ul>



**FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS**

<p align="center"><b>Kompetenca</b></p> <p align="center"><b>Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së TIK-ut</b></p>	<p align="center"><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><i>Mësuesi i TIK-ut:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• dallon konceptet dhe shprehitë kryesore me të cilat operon lënda e TIK-ut në VI-IX dhe X-XII;</li> <li>• përshkruan mënyrën e formimit të koncepteve të TIK-ut për klasat VI-IX dhe X-XII;</li> <li>• përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe shprehive;</li> <li>• dallon ndërvarësinë e koncepteve të TIK-ut;</li> <li>• zgjidh me saktësi dhe me mënyra të ndryshme situata ushtrimesh në TIK të cilat përdorin konceptet dhe aftësitë e programeve VI-IX dhe X-XII;</li> <li>• zotëron njohuri mbi përdorimin e kompjuterit;</li> <li>• zotëron njohuri mbi programet aplikative (Word, Excel, PowerPoint, Access) dhe sistemet e shfrytëzimit;</li> <li>• zotëron njohuri mbi internetin dhe e-mailin;</li> <li>• zotëron njohuri mbi ndërtimin e rrjeteve kompjuterik dhe llojin e tyre.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tekste të lëndës për mësuesin dhe nxënësin, materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës.</li> <li>• Programe dhe tekste të lëndës së TIK-ut për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët dhe X - XII për arsimin e mesëm të lartë.</li> </ul>